

**Nexhat Daci** (i lindur më 26 korrik 1944) në Tërnoc. Politikan kosovar nga Lidhja Demokratike e Dardanisë (LDD). Kryetar i Kuvendit të Kosovës gjatë periudhës 2001-2006, profesor i kimisë, doktor i shkencave të kimisë nga Universiteti i Zagrebit. Anëtar i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, Akademisë Evropiane për çështje mjedisi dhe American Chemical Society.

## **Jeta**

Ai është i martuar dhe ka tre fëmijë. Banon në lagjen Velani në Prishtinë. Flet gjuhën shqipe, serbe, angleze, kroate dhe gjermane (pasive).

## **Arsimimi**

1956-1960 Shkolla e mesme

1962-1966 Universiteti, Seksioni i Kimisë

Beograd, diploma: kimist i diplomuar

1966-1968 Universiteti i Beogradit, studime pasuniversitare, Seksioni i kimisë, magjistër i kimisë

1969-1973 Universiteti i Zagrebit, Fakulteti i Teknologjisë, Zagreb, Kroaci, doktor i shkencave të kimisë

## **Aktivitete dhe funksione, të tanishme apo paraprake**

1968-1970 Universiteti i Prishtinës, Seksioni i Kimisë, Asistent

1970-1974 Universiteti i Prishtinës, Seksioni i Kimisë, Ligjërues

1973 Hidroprojekt, Brno, Çekosllovakia

1974 University of Bradford, England

1974-1984 Universiteti i Prishtinës, Seksioni i Kimisë, Profesor inordinar

1979 Viziting profesor, Tiranë

1984-1997 Universiteti i Prishtinës, Seksioni i Kimisë, Profesor ordinar